



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 14

Tiranë – E martë, 27 prill 2020

PËRMBAJTJA

Faqe

Njoftim i Ministrisë së
Infrastrukturës dhe
Energjisë
nr. 639/2, datë 22.4.2020

Për publikimin e një ndryshimi në ftesën për ofertë për procesin konkurrues,
“Për përzgjedhjen e projektit që do të përfitojë masat mbështetëse për
ndërtimin e impiantit fotovoltaiik në zonën e Karavastasë”.....

3

**NJOFTIM**

Nr. 639/2, datë 22.4.2020

**PËR PUBLIKIMIN E NJË NDRYSHIMI
NË FTESËN PËR OFERTË PËR
PROCESIN KONKURRUES, “PËR
PËRZGJEDHJEN E PROJEKTIT QË
DO TË PËRFITOJË MASAT
MBËSHTETËSE PËR NDËRTIMIN E
IMPIANTIT FOTOVOLTAIK NË
ZONËN E KARAVASTASË”**

Bazuar në vendimin nr. 349, datë 12.6.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për për zgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka shpallur ftesën për ofertë për procesin konkurrues për për zgjedhjen e ofertuesit për zhvillimin e “Projektit për ndërtimin e impiantit fotovoltaik, në zonën e Karavastasë”.

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
“PËR NJË NDRYSHIM NË FTESËN
PËR OFERTË”**

Në ftesën për ofertë për Procesin Konkurrues, “Për për zgjedhjen e projektit që do të përfitojë masat mbështetëse për ndërtimin e impiantit fotovoltaik në zonën e Karavastasë”, të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, të datës 20.1.2020 dhe 27.2.2020, bëhet ndryshimi i afatit për dorëzimin e ofertave dhe hapjes së ofertave, si më poshtë:

Afati për dorëzimin e ofertave: 30 prill 2020, ora 12:00 (ora e Evropës Qendrore).

Nëse oferta dorëzohet me postë, do të konsiderohet se është dorëzuar rregullisht brenda afatit të dorëzimit të ofertave, nëse përmbush kumulativisht:

- data e shënuar në vulën postare të zarfeve, e konfirmuar me anë të njoftimit të shërbimit postar, është jo më vonë se afati i dorëzimit të ofertave (dmth 30 prill 2020, ora 12:00, ora e Evropës Qendrore);

- MIE e merr Ofertën jo më vonë se data e hapjes së ofertave (dmth 8 maj 2020, ora 17:00, ora e Evropës Qendrore).

MIE do të lëshojë konfirmimin e marrjes së ofertës, me datën dhe orën e marrjes. Ofertat e dorëzuarra në dorë pas afatit të dorëzimit të ofertave (i ndryshuar) ose ofertat e dorëzuara me postë që nuk përmbushin kumulativisht kushtet e mësipërme, nuk do të shqyrtohen.

Hapja e ofertave: 17 maj 2020, ora 12:00 (ora e Evropës Qendrore).

Informacion shtesë mbi dokumentet e procesit konkurrues mund të gjeni në *Website*-in e Autoritetit Kontraktues:

<http://infrastruktura.gov.al>.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Viola Haxhiademi

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.